

AKTI I THEMELIMIT
TË SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“XHML Lala” shpk

Sot, më 26.02.2025, themeluesi,

- a) **Marin Lala**, i datëlindjes 21/05/1972, shtetas shqiptar, identifikuar me anë të letërnjoftimit me numër 036201301, me numër personal identifikimi H20521119H, lindur në Mnelë dhe banues në njësinë administrative Vig-Mnelë; madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

po krijon një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar sipas kushteve të mëposhtëme.

Neni 1
Themelimi

- 1) Emri i shoqërisë është **“XHML Lala” shpk**.
- 2) Shoqëria themelohet në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar në përputhje me legjislacionin shqiptar.
- 3) Shoqëria fiton personalitet juridik me regjistrimin në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Neni 2:
Objekti

- 1) Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:

Ndërtime të objekteve të banimit, shërbimit apo prodhimit industrial, me një apo shumë kate. Ndërtime infrastrukturore, rrugore, hidrike, restaurime, rikonstruksione, të objekteve të ndryshme përfshirë edhe ato të trashëgimisë kulturore. Prodhim dhe përpunim i të gjithë materialeve të ndërtimit me mjete të motorizuara, mekanike, piroteknike, etj. Import-eksport dhe tregtim me shumicë e pakicë, të artikujve industrial, elektroshtëpiak, ushqimor, materiale ndërtimi, lëndë drusore, etj, përfshirë produkte dhe nënprodukte të tyre, si dhe mjeteve të motorizuara të të gjitha markave dhe fuqive motorike, për përdorim: familjar, bujqësor, transportit njerëzor dhe/apo materialeve të ndërtimit. Shërbime në pastrim, grumbullim dhe transportim të inerteve, mbetjeve urbane dhe rurale. Tregtim dhe montim i paisjeve për prodhimin e energjisë elektrike me sistemet fotovoltaike apo metodave të tjera alternative ekuivalente. Veprimtari të kultivimit/prodhimit dhe tregëtimit bujqësor, blegtoral, kulturave frutore, si dhe produkteve dhe nënprodukteve respektive. Veprimtari në fushën e hotelieritizmit, bare, restorante, agjensi udhëtimesh dhe/apo turistike. Shërbim i ruajtjes së sigurisë fizike dhe morale të objekteve dhe/apo personit.

Neni 3:
Kohëzgjatja

- 1) Kohëzgjatja e shoqërisë është e pacaktuar.

Neni 4:
Selia

- 1) Shoqëria e ka selinë në rrugën “Pal Lazri 03510031”, nr. nd.35, fshati Mnelë e Vogël, Njësia Administrative Vig-Mnelë.
- 2) Me vendim të organit administrativ, shoqëria mund të hapë degë ose zyra përfaqësimi brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë.

Neni 5
Kapitali themeltar

Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 100.000 (njëqind mijë) lekë dhe është i ndarë në 1(një) kuota. Ortaku themelues i Shoqërisë zotëron kuotat në këtë shoqëri si më poshtë:

- Z.Marín Lala, zotëron 1(një) kuotë në vlerën 100.000 lekë (njëqind mijë) lekë apo 100% (njëqind) të kapitalit të shoqërisë.

Kontributi i ortakëve është në para.

Neni 6
Administratori

- 1) Administrator i shoqërisë është Z.Marín Lala, lindur dhe banues në njësinë administrative Vig-Mnelë, i datëlindjes 21.05.1972 me adresë rr.“Pal Lazri 03510031”, nd.nr 35 dhe fshati Mnelë e Vogël, mbajtës i letërnjoftimit me nr.serie: 036201301 dhe nr.personal H20521119H, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me afat emërimi 5 vjeçar.

Neni 7
Baza Ligjore

- 1) Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar në fuqi.
- 2) Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 8
Mosmarrëveshjet

- 1) Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin nga moskuptimi apo keqinterpretimi i neneve të mësipërme, do të paraprihen nga vullneti i mirëkuptimit për zgjidhjen e tyre, në të kundërt ato do të zgjidhen nëpërmjet organeve të parashikuara me ligj.

O R T A K U
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“XHML Lala” shpk

Mari Lalo 

(Emër, Mbiemër, Nënshkrimi)